



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 225, datë 15.12.2020

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 202, SERIA PV13K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “HEC TRESKA” SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 80, DATË 27.04.2013.

Në mbështetje të nenit 16 dhe 42, pika 1, gërma “ç”, të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 5, gërma “ç”, dhe nenit 6, të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 58, datë 18.04.2017; pikës 3.6, pikës 4,4 dhe pikës 6.1, të “Kushteve të Licencës për Prodhimin e Energjisë Elektrike; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2020, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 131/1 prot, datë 07.12.2020, të përgatitur nga Grupi i punës, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencave të subjekteve debitore ndaj ERE-s për pagesat e rregullimi”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “HEC TRESKA” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 80, datë 27.04.2013, për një afat 30-vjeçar.
- Me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 263, datë 19.12.2018, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2018 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.
- Vendimi i Bordit të ERE sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 202, datë 01.02.2019. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim, edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 55/70 Prot, datë 15.01.2019.
- Me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 212, datë 18.12.2019, ERE ka përcaktuar pagesat e rregullimit për vitin 2019 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike.
- Vendimi i Bordit të ERE sipërcituar është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 188, datë 13.01.2020. Përveç botimit në Fletoren Zyrtare, i licencuari ka marrë dijeni për këtë vendim edhe nëpërmjet njoftimit të ERE-s, nëpërmjet shkresës nr. 412/124 Prot, datë 06.02.2020.

- Me vendimin Nr. 103, datë 24.06.2020 “Mbi të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror të cilët nuk kanë shlyer pagesat rregullatore”, Bordi i ERE-s ka vendosur:
 1. Shtyrjen deri në datën 31.07.2020 të afatit të shlyerjes së detyrimeve aktuale të vitit 2019 dhe atyre të prapambetura, të të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror të parashikuar në nenin 17, pika 5 të ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.
 2. Të gjithë të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, të cilët janë debitorë ndaj ERE-s në shlyerjen e pagesave të rregullimit, të shlyejnë detyrimet aktuale dhe ato të prapambetura, jo më vonë se data 31.07.2020.
 3. Me përfundimin e afatit të parashikuar në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, për subjektet që nuk kanë shlyer detyrimet në kohë, ERE do të marrë masat administrative, në përputhje me nenin 107, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.
- I licencuari “HEC TRESKA” sh.p.k. është njoftuar për vendimin e sipërcituar nëpërmjet shkresës së ERE-s nr. 960/25 Prot, datë 09.07.2020. Edhe pas përfundimit të afatit të përcaktuar në vendimin sipërcituar, rezultoi se subjekti nuk kishte marrë asnjë masë për shlyerjen e debisë.
- Me urdhrin e Kryetarit nr. 125/2020, “Për fillimin e hetimit administrativ për marrjen e masave ligjore ndaj të licencuarve debitorë për pagesat e rregullimit të pashlyera ndaj ERE”, u ngrit grupi i punës që do të hetonte për përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave të çdo debitori me qëllim marrjen e masave të nevojshme ligjore administrative apo në rrugë gjyqësore, për minimizimin e dëmit të shkaktuar, si dhe vjeljen e debive të akumuluar.
- Shoqërisë “HEC TRESKA” sh.p.k. i është dërguar shkresa nr. 1172/5 Prot, datë 04.11.2020, duke i bërë me dije që në zbatim të nenit 6 të Rregullores për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave, me urdhrin e sipërcituar ka filluar procedura hetimore, duke i kërkuar që brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi të japë shpjegimet përkatëse në lidhje me statusin e shlyerjes së debisë që ka ndaj ERE-s, për shlyerjen e pagesës së Rregullimit, për vitet në të cilat është debitor. Gjithashtu iu kërkua që të përcillte në ERE çdo dokument që vlerësonte se mund t’i shërbente hetimit administrativ të filluar me urdhrin e Kryetarit.
- Në përfundim të afateve, të përcaktuara në këtë njoftim, rezultoi se subjekti “HEC TRESKA” sh.p.k. nuk ka përcjellë në ERE as shpjegime dhe as dokumentacion për sa kërkuar.
- Për sa më sipër rezulton se grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari:
 1. Mosshlyerja në afat e pagesës së rregullimit për vitin 2018 dhe për vitin 2019
- Shoqëria e licencuar rezulton debitore për dy vite të njëpasnjëshme për mosshlyerjen në afat të pagesave të Rregullimit ndaj ERE-s.
- Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, në nenin 107 parashikon se, për moskryerjen e pagesës rregullatore nga ana e të licencuarit brenda afatit të përcaktuar, ERE ndëshkon me gjobë deri në 3 për qind të të ardhurave të vitit paraardhës të të licencuarit si dhe ka të drejtë të aplikojë një kamatëvonesë mbi vlerën e pagesës rregullatore, në masën e 0.2 % të xhiros ditore për çdo ditë vonesë në pagesën e saj dhe në germën ç), të nenit 42 parashikon se, ERE heq një licencë kur i licencuari nuk kryen pagesat e rregullimit, të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga neni 17 i këtij ligji.

- Neni 6 i Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 52, datë 18.04.2017, parashikon se:
 - Në çdo rast, subjekti ndaj të cilit fillon një procedurë për heqjen e licencës duhet që me marrjen dijani, të shlyejë çdo pagesë rregullatore të pashlyer ndaj ERE. Në asnjë rast subjekti i licencuar debitor, nuk çlirohet nga ky detyrim ndaj ERE, edhe pas marrjes së vendimit për fillimin e procedurës për heqjen e licencës. Bordi mund të vendosë marrjen e masave administrative konform nenit 107, të ligjit 43/2015 e cila përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me Kodin e Procedurës Civile.
 - Grupi i punës ka konstatuar shkelje nga ana e këtij të licencuari, të pikës 3.6 të Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike.
- Në nenin 4.4 të Kushteve të licencës së Prodhimit parashikohet se: I licencuari ka detyrimin për të informuar ERE-n duke dhënë shpjegimet dhe arsyet për çdo shkelje të këtyre Kushteve të Licencës brenda 7 ditëve pune nga momenti kur kjo shkelje bëhet e njohur për të Licencuarin.
- Në pikën 2 të Vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 99, datë 17.06.2016 “Mbi miratimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike”, është përcaktuar si *Efektet e kësaj licence për subjektet e licencuara përpara hyrjes së saj në fuqi, fillojnë me miratimin e këtij vendimi dhe për periudhën e mbetur të kohës së parashikuar në licencën aktuale*, ndaj të gjitha subjektet e licencuara përpara hyrjes në fuqi të kësaj licence, janë të detyruar të zbatojnë kushtet e saj deri në përfundimin e vlefshmërisë së licencës së tyre.
- Detyrimi për shlyerjen e pagesës së rregullimit, është fakt për të cilin zyrtarisht i licencuari ka marrë dijani në kohë nëpërmjet publikimeve në Fletoren Zyrtare të Vendimeve për pagesat e Rregullimit ndër vite, por edhe njoftimeve të përsëritura të dërguara për dijani të tyre nga ERE, siç edhe cituar më sipër.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 202, seria PV13K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HEC TRESKA”, me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 80, datë 27.04.2013.
2. I licencuari ka të drejtë për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për fillimin e procedurave për heqjen e licencës.
3. Grupi i Punës të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE

Petrit AHMETI